



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

RELACION

Data
07.12.2020

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TË LËNDËS SË POSAÇME PËR TIMBRIMIN E ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021”

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “b” dhe “n”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e specifikimeve të lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

Referuar nenit 99, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgon në KZAZ materialet zgjedhore të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi. Në paragrafin 1, shkronja “ë” të dispozitës sipërcituar parashikohet dërgimi i materialit zgjedhor “lëndë të posaçme për timbrimin e zgjedhësit”.

Referuar eksperiencës të organizimit dhe administrimit të proceseve zgjedhore, dhomat e fshehta, sipas specifikimeve teknike të miratuara nga KQZ, kanë garantuar fshehtësinë e votimit, kanë qenë të përshtatshme për zgjedhësin gjatë shënimit të fletës së votimit, si dhe kanë ofruar lehtësi për komisionerët në organizimin e qendrës së votimit.

Projektvendimi i paraqitur, parashikon të njëjtin model dhe specifikime për lëndën e posaçme për timbrimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Lënda e posaçme për timbrimin e zgjedhësve e përdorur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në procese zgjedhore, tip “marker”, me përmbajtje 20% nitrat argjendi, e vlefshme për timbrimin e së paku 500 zgjedhësve, ka patur efekt të menjëhershëm, ka qënë e dukshme me shikim të lirë, rezistente për më shumë se 24 orë, e pacënueshme nga çdo veprim i jashtëm, dhe njëherazi e padëmshme për organizimin

Ana TENOLLI – Drejtorja e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

Madalena KOJA – Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm